

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MËDITËS, PLANIFIKIMIT DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SPOJNE, PROJEKTOVANJE I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. jedinica Org. Unit Në i Faqeve Br. Stranica No. Pages	DPANB / Në i Prot. Broj Prot. Prot. No. Data: Datum: Date:
8651/24 31.12.24 PRISHTINË / A No. 1	

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në mbështetje të Nenit 10 paragrafit 1, nën-paragrafit 1.2, Nenit 12 paragrafit 3, nën-paragrafit 3.1, Nenit 26 paragrafit 9, Nenit 28 paragrafit 7 dhe Nenit 29 paragrafit 5 të Ligjit nr. 08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (Gazeta Zyrtare nr.1, 17 janar 2022), Kuvendi i Odës së Inxhinierëve të Republikës të Kosovës miraton:

RREGULLORE PËR PROCEDURËN E LICENCIMIT, RILICENCIMIT, MIRËMBAJTJEN, PEZULLIMIN DHE REVOKIMIN E LICENCËS SË INXHINIERIT TË LICENCUAR TË ODËS

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i procedurës për licencimin e inxhinierëve nga Oda e Inxhinierëve të Republikës të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Oda), rilicencimin e tyre, rregullave për mirëmbajtjen e licencës, si dhe pezullimin dhe revokimin e licencës së inxhinierit të licencuar të Odës, në përputhje me Ligjin në fuqi.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet për Odën dhe organet e saj si dhe të gjithë inxhinierët në Republikën e Kosovës që aplikojnë për licencim dhe që licencohen nga Oda.
2. Kjo Rregullore nuk zbatohet për inxhinierët e licencuar jashtë Republikës së Kosovës, të cilët angazhohen në veprimtari profesionale në Republikën e Kosovës. Njohja e licencave profesionale të tyre bëhet përmes Rregullores së veçantë të Odës.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

1.1. Inxhinier –Inxhinier i licencuar nga Oda në përputhje me Ligjin në fuqi dhe rregulloren përkatëse;

2. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin Nr. 08/L – 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji në fuqi).
3. Emrat në njërin gjini të përdorura në këtë Rregullore nënkuptojnë edhe emrat në gjininë tjetër, pa diskriminim.

KAPITULLI II

E DREJTA E USHTRIMIT TË PROFESIONIT DHE LICENCAT

Neni 4

E drejta e ushtrimit të profesionit të inxhinierit

Të drejtën e ushtrimit të profesionit të inxhinierit në Republikën e Kosovës e ka inxhinieri i cili posedon licencën profesionale të vlefshme të lëshuar nga Oda dhe është anëtar i Odës.

Neni 5

Licencat profesionale

1. Licencat për inxhinier ndahen në Kategorinë A dhe Kategorinë B në përputhje me Ligjin në fuqi.
2. Për licencim sipas kësaj Rregulloreje, aplikuesi plotëson në mënyrë kumulative kushtet në vijim:
 - 2.1. Është shtetas i Republikës së Kosovës ose posedon lejeqëndrim në Republikën e Kosovës;
 - 2.2. Për licencë të Kategorisë A:
 - 2.2.1. Ka të përfunduar studimet akademike në fushën e inxhinierisë së paku pesë (5) vite dhe diplomën përkatëse;
 - 2.2.2. Ka përvojë pune të profesionit të inxhinierit për së paku një (1) vit pas përfundimit të studimeve akademike nga nën-paragrafi 2.2.1.
 - 2.3. Për licencë të Kategorisë B:
 - 2.3.1. Ka të përfunduar studimet akademike në fushën e inxhinierisë së paku tre (3) vite dhe diplomën përkatëse;
 - 2.3.2. Ka përvojë pune të profesionit të inxhinierit për së paku dy (2) vite pas përfundimit të studimeve akademike nga nën-paragrafi 2.3.1, apo përvojë

pune një (1) vjeçare të profesionit të inxhinierit, pas përfundimit të studimeve akademike katër (4) vjeçare në fushën e inxhinierisë.

2.4. Pagues taksën për licencim dhe tarifën vjetore të anëtarësisë në Odë.

3. Aplikuesi i cili ka të përfunduar studimet akademike në fushën e inxhinierisë së paku pesë (5) vite dhe diplomën përkatëse, por nuk ka përvojën e kërkuar nga nën-paragrafi 2.2.2, plotëson kushtet për licencim për Kategorinë B. Me vërtetimin e arritjes së përvojës nga nën-paragrafi 2.2.2, inxhinieri mund të licencohet për licencën e Kategorisë A, me ç'rast paraqet aplikimin për këtë licencë.

4. Numri i viteve të studimeve akademike përkatëse të kërkuara sipas këtij Neni mund të dëshmohet po ashtu përmes numrit ekuivalent të kredive ECTS.

5. Për qëllime të paragrafit 4:

5.1. Studimet akademike në fushën e inxhinierisë tre (3) vjeçare nënkupton diplomim në nivelin e parë, apo së paku njëqindetëdhjetë (100) kredi ECTS;

5.2. Studimet akademike në fushën e inxhinierisë katër (4) vjeçare nënkupton diplomim në nivelin e parë, apo së paku dyqindetëdhjetë (200) kredi ECTS, dhe

5.3. Studimet akademike përkatëse pesë (5) vjeçare nënkupton diplomim në nivelin e dytë, apo së paku dyqindetëdhjetë (200) kredi ECTS.

6. Inxhinieri i licencuar në Kategorinë B mund të aplikoj për licencë të Kategorisë A pas plotësimit të kushteve të përcaktuara për licencë të Kategorisë A nga nën-paragrafi 2.2 i këtij Neni.

Neni 6

Licencimi përmes Sistemit Elektronik

1. Procedurat e përcaktuara në këtë Rregullore zbatohen përmes Sistemit Elektronik të Odës (në tekstin e mëtejshëm: sistemi elektronik).

2. Format elektronike të aplikimit për licencim dhe rilicencim, vendimet për këto aplikime, format e njoftimit, vendimet për pezullim ose revokim, si dhe format tjera në kuadër të sistemit elektronik, që duhet të jenë në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Rregullore dhe legjislacionin në fuqi, përcaktohen me vendim të Bordit Drejtues të Odës (në tekstin e mëtejshëm Bordi).

3. Dokumentet që ngarkohen në sistemin elektronik gjatë zbatimit të procedurave të kësaj Rregulloreje janë të kualitetit të mirë dhe në përputhje me formatin dhe kërkesat e sistemit.

4. Zbatimi i procedurave të kësaj Rregulloreje mund të bëhet në formë fizike në rast të mos-funksionimit të ndërfaqes së sistemit elektronik për një periudhë që është më e gjatë se dyzetetetë (48) orë, ose kur natyra e çështjes është urgjente sipas përcaktimit të Bordit dhe rrethanat e kërkojnë një zbatim të tillë.

KAPITULLI III

PROCEDURA E LICENCIMIT DHE RILICENCIMIT

Neni 7

Kompetencat, emërimi, përbërja dhe mandati i Komisionit Vlerësues

1. Komisioni Vlerësues është përgjegjës për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për aplikimet për licencim nga inxhinierët.
2. Komisioni Vlerësues emërohet nga Bordi dhe përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët zgjedhën nga radhët e anëtarëve të Bordit.
3. Mandati i anëtarëve të Komisionit Vlerësues korrespondon me mandatin e tyre në Bord.
4. Anëtarit që i pezullohet licenca apo e humb mandatin si anëtar i Bordit për arsye të përcaktuara me Ligjin në fuqi dhe aktet përkatëse të Odës, nuk mundet të shërbej në Komision Vlerësues.

Neni 8

Aplikimi për licencim

1. Aplikimi për licencim nga inxhinieri paraqitet në formë elektronike, përmes ndërfaqes së sistemit elektronik.
2. Forma elektronike e aplikimit në përputhje me Ligjin në fuqi dhe këtë Rregullore, përcaktohet me vendim të Bordit.
3. Përmes sistemit, aplikuesi vërteton duke ofruar të dhënat personale dhe fotografinë personale, apo ngarkuar dokumentet përkatëse, plotësimin e kushteve nga Neni 5. Aplikuesi paraqet në sistem gjithashtu deklaratën e përgjegjësisë profesionale.
4. Për vërtetimin e plotësimit të kushtit të përfundimit të studimeve përkatëse, aplikuesi paraqet diplomën nga institucioni arsimor i akredituar në Republikën e Kosovës, ose diplomën e nostrifikuar në Republikën e Kosovës të institucionit arsimor jashtë Republikës së Kosovës.
5. Për vërtetimin e plotësimit të kushtit të përvojës përkatëse, aplikuesi paraqet të dhënat dhe vërtetimin përkatës sipas mënyrës së përcaktuar me vendim nga Bordi. Në rast të punës praktike si inxhinier, aplikuesi paraqet të dhënat që dëshmojnë përvojën e punës praktike të konfirmuar nga Oda.

6. Aplikimi është pa pagesë dhe i njëjti pranohet në sistem elektronik vetëm nëse ofrohen të gjitha të dhënat e kërkuara ose ngarkohen dokumentet përkatëse të kërkuara.
7. Me rastin e aplikimit, sistemi elektronik gjeneron një vërtetim që dëshmon aplikimin, datën, qëllimin e aplikimit dhe listën e dokumenteve të bashkëngjitura.

Neni 9

Shqyrtimi i aplikimit dhe vendimi për licencim

1. Komisioni Vlerësues shqyrton aplikimin për licencim dhe vendos për të në afat prej tridhjetë (30) ditë nga paraqitja e aplikimit.
2. Komisioni Vlerësues në bazë të të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura vërteton plotësimin e kushteve për licencim të aplikuesit sipas kategorive përkatëse të përcaktuara në paragrafin 1 të Nenit 5, dhe merr vendim për dhënie apo refuzim të licencës.
3. Në rast të aplikimit të paqartë ose i cili duhet të plotësohet, Komisioni kontakton aplikuesin për sqarime të mëtejshme apo plotësimin e aplikimit në një afat të arsyeshëm kohor. Këtu përfshihen edhe rastet kur Komisioni ngrit dyshime për vërtetësinë e të dhënave ose dokumenteve të paraqitura, me ç'rast aplikuesi detyrohet të paraqes në formë fizike origjinale dokumentin e kontestuar.
4. Komisioni ka të drejtë të verifikoj vërtetësinë e dokumentit edhe përmes organit që e ka lëshuar atë.
5. Në rast të mos ofrimit të sqarimeve të nevojshme apo plotësimit të aplikimit sipas udhëzimeve të Komisionit dhe afatit të përcaktuar në paragrafin 3, Komisioni refuzon aplikimin.

Neni 10

E drejta në ankesë dhe shqyrtimi i saj

1. Kundër vendimit për refuzim të licencës të Komisionit Vlerësues, aplikuesi mund të paraqet ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditë nga dita e njoftimit të vendimit.
2. Rregullat për paraqitjen e aplikimit për licencë nga Neni 8 zbatohen përshtatshmërisht për rregullat për paraqitjen e ankesës.
3. Ankesa shqyrtohet në afat prej tridhjetë (30) ditë nga paraqitja e saj. Ky afat është kumulativ dhe zbatohet për procedurën e shqyrtimit nga Komisioni Vlerësues dhe nga Komisioni i Ankesave, në përputhje me paragrafët vijues.
4. Ankesa shqyrtohet së pari nga Komisioni Vlerësues.

5. Në rast se vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar plotësisht, Komisioni Vlerësues anulon vendimin paraprak, dhe merr vendim për dhënie të licencës për aplikuesin.
6. Në rast se vlerëson se ankesa nuk është plotësisht e pranueshme dhe e bazuar, Komisioni Vlerësues pa vonesë dhe më së largu brenda pesë (5) ditëve përcjellë ankesën tek Komisioni i Ankesave.
7. Komisioni i Ankesave mund të kryej shqyrtime administrative shtesë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, apo urdhëroj Komisionin Vlerësues që të zhvillojë shqyrtime të tilla dhe të njoftojë për to, mirëpo nuk mund të kthej lëndën në rishqyrtim dhe vendosje te Komisioni Vlerësues.
8. Në rast se vlerëson se ankesa është e papranueshme ose e pa bazuar, Komisioni i Ankesave e refuzon atë dhe vërteton vendimin e Komisionit Vlerësues. Në të kundërtën, Komisioni i Ankesave aprovon ankesën, anulon vendimin e Komisionit Vlerësues dhe merr vendim për dhënie të licencës për aplikuesin.
9. Vendimi i Komisionit të Ankesave është përfundimtar. Pala e pakënaqur me vendimin e Komisionit të Ankesave mund t'i drejtohet gjykatës kompetente.

Neni 11

Dhënia e licencës dhe kohëzgjatja

1. Pas vendimit për plotësimin e kushteve për licencim, para se të lëshohet licenca, aplikuesi paguan taksën për licencim dhe tarifën një (1) vjeçare për anëtarësim në Odë sipas vlerave të përcaktuara me Rregulloren përkatëse.
2. Pas pagesës së taksës për licencim dhe tarifës vjetore në përputhje me paragrafin 1, aplikuesit i lëshohet licenca me vlefshmëri pesë (5) vite. Me dhënie të licencës, inxhinieri i licencuar bëhet anëtar i Odës.
3. Licenca përmban të dhënat në vijim:
 - 3.1. Emrin e Odës;
 - 3.2. Numrin identifikues të licencës dhe datën e lëshimit të licencës;
 - 3.3. Emrin, mbiemrin dhe datën e lindjes të anëtarit të licencuar;
 - 3.4. Kategorinë e licencës;
 - 3.5. Kualifikimet përkatëse akademike të anëtarit të licencuar;
 - 3.6. Periudhën e vlefshmërisë së licencës dhe
 - 3.7. Nënshkrimin e Kryetarit të Odës.

4. Formati i licencës përcaktohet me vendim të Bordit.
5. Të gjitha licencat e dhëna bëhen pjesë e regjistrit të personave të licencuar i cili publikohet në formë elektronike në faqen elektronike të Odës.

Neni 12

Mirëmbajtja e licencës

1. Inxhinieri i licencuar me marrjen e licencës fiton të drejtën të veproj si profesionist i inxhinierisë dhe të përdor titullin “inxhinier i licencuar”.
2. Me dhënien e licencës, Oda i lëshon inxhinierit të licencuar kartelën identifikuese dhe vulën, të cilat janë pronë e Odës dhe përdoren nga inxhinieri për sa kohë licenca është valide. Për lëshimin e kartelës dhe vulës mbahet shënim i veçantë.
3. Inxhinieri i licencuar detyrohet që t’i nënshtrohet edukimit të vazhdueshëm profesional për avancimin e shkathtësive të profesionit që e ushtron dhe për mbajtjen e licencës.
4. Në çdo kohë gjatë ushtrimit të profesionit, inxhinieri i licencuar detyrohet që të respektoj rregullat etike dhe aktet tjera të Odës, si dhe legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.
5. Licenca është individuale dhe nuk mund të bartet tek personi tjetër.
6. Për çdo ndryshim në të dhënat personale apo informatat tjera lidhur me licencën, inxhinieri i licencuar detyrohet të njoftoj Odën.
7. Forma, përmbajtja dhe standardet e kartelës identifikuese dhe vulës përcaktohen me vendim të Bordit.
8. Inxhinieri që dëmton ose humb kartelën identifikuese ose vulën, ka të drejtë të pranoj kartelën dhe vulën e re kundrejt pagesës që bëhet në përputhje me vlerën e përcaktuar në Rregulloren përkatëse.

Neni 13

Rilicencimi

1. Oda njofton përmes sistemit elektronik inxhinierin e licencuar për skadimin e licencës tre (3) muaj para skadimit.
2. Të drejtën e rilicencimit e ka inxhinieri i licencuar i cili:

- 2.1. vazhdon plotësimin e kushteve nga Neni 5;
 - 2.2. ka fituar pikët kredituese të mjaftueshme të edukimit të vazhdueshëm profesional, në përputhje me Rregulloren përkatëse, dhe
 - 2.3. Pagan taksën e rilicencimit.
3. Aplikimi për rilicencim nga inxhinieri i licencuar paraqitet më së largu tridhjetë (30) ditë para datës së skadimit të licencës.
4. Në rast të paraqitjes së aplikimit pas këtij afati dhe afati i licencës së inxhinierit ndërkohë skadon pa marrjen e vendimit nga Oda për rilicencim të inxhinierit, licenca e inxhinierit do të evidentohet si e skaduar në regjistrin përkatës të licencave dhe inxhinieri humb të gjitha të drejtat si në rastet e pezullimit të licencës, deri në rilicencimin e tij.
5. Gjatë procesit të aplikimit për rilicencim, aplikuesi nuk ka nevojë të paraqes të dhënat apo dokumentet valide të cilat janë ngarkuar në sistem elektronik gjatë aplikimit për licencim apo të cilat janë në posedim të Odës. Aplikuesit i kërkohen vetëm informatat e nevojshme për identifikimin e tyre.
6. Komisioni Vlerësues shqyrton dhe vendos për aplikimin për rilicencim në afat prej tridhjetë (30) ditë nga data e dorëzimit të aplikimit. Kundër vendimit të Komisionit Vlerësues, aplikuesi ka të drejtë të paraqes ankesë.
7. Rregullat e përcaktuara në Nenin 8, 9, 10 dhe 11 për aplikimin për licencim, shqyrtimin e aplikimit, ankesën dhe dhënien e licencës e kohëzgjatjen zbatohen përshtatshmërisht gjatë procedurës së rilicencimit.

KAPITULLI IV PEZULLIMI DHE REVOKIMI I LICENCËS

Neni 14 Pezullimi i licencës

1. Inxhinierit të licencuar i pezullohet licenca nëse:
 - 1.1. Gjykata me aktgjykim të plotfuqishëm shpall ndaj inxhinierit të licencuar dënimin për ndalimin e ushtrimit të profesionit;
 - 1.2. i është shqiptuar masa disiplinore për ndalimin e ushtrimit të punëve profesionale;
 - 1.3. nuk paguan tarifën vjetore të anëtarësisë;

- 1.4. nuk i është nënshtruar kushteve për edukimin e vazhdueshëm profesional;
 - 1.5. inxhinieri i licencuar vet e kërkon atë.
2. Komisioni Vlerësues vendos për pezullimin e licencës së inxhinierit, sipas detyrës zyrtare me plotësimin e njërit nga kushtet nga paragrafi 1. Vendimi për pezullim merret pa vonesë nga momenti i kuptimit të përmbushjes së njërit nga kushtet për pezullim.
 3. Kërkesa nga inxhinieri për pezullimin e licencës në rastet e nën-paragrafit 1.5 paraqitet përmes sistemit elektronik në formë të arsyetuar.
 4. Me vendimin për pezullimin e licencës, inxhinierit i pezullohet e drejta e ushtrimit të profesionit të inxhinierit dhe të gjitha të drejtat dhe detyrat e përcaktuara me Ligjin në fuqi dhe aktet nënligjore të Odës.
 5. Me pezullimin e licencës profesionale pezullohet edhe anëtarësia e inxhinierit në Odë.
 6. Me vendimin për pezullimin e licencës, anëtarit të licencuar i pezullohet edhe mandati në cilindo organ të Odës.
 7. Vendimi për pezullimin e licencës shfuqizohet pa vonesë me kërkesë të vet inxhinierit të licencuar apo sipas detyrës zyrtare kur përfundon arsyeja për të cilën i është vendosur pezullimi. Me shfuqizim të vendimit, inxhinierit të licencuar i kthehen të gjitha të drejtat dhe detyrat e përcaktuara me Ligjin në fuqi dhe aktet nënligjore të Odës.
 8. Organet përkatëse të Odës janë të detyruara të njoftojnë pa vonesë Komisionin Vlerësues për plotësimin e kushtit për pezullim të licencës së inxhinierit.

Neni 15

Revokimi i licencës

1. Inxhinierit të licencuar i revokohet licenca:
 - 1.1. nëse dëshmohet se ka humbur zotësinë për të vepruar në mënyrë të përhershme;
 - 1.2. me vendim të Gjykatës;
 - 1.3. me vdekjen e tij;
 - 1.4. nëse vet e kërkon revokimin.
2. Komisioni Vlerësues vendos për revokimin e licencës, me plotësimin e njërit nga kushtet e paragrafit 1. Vendimi për revokim merret pa vonesë nga momenti i kuptimit të përmbushjes së njërit nga kushtet për revokim.

3. Kërkesa nga inxhinieri për revokimin e licencës në rastet e nën-paragrafët 1.4 paraqitet përmes sistemit elektronik në formë të arsyetuar.
4. Me vendimin e plotfuqishëm për revokimin e licencës, inxhinieri humb në mënyrë të përhershme titullin “inxhinier i licencuar” dhe të drejtën për kryerjen e veprimeve profesionale si dhe të gjitha të drejtat dhe detyrat e përcaktuara më Ligjin në fuqi dhe aktet nënligjore të Odës.
5. Me vendimin për revokimin e licencës, anëtarit të licencuar i përfundon edhe mandati në cilindo organ të Odës si dhe i revokohet anëtarësia në Odë.

Neni 16

Njoftimi për vendimin për pezullim ose revokim të licencës dhe e drejta e ankesës

1. Për vendimin për pezullim ose revokim të licencës, inxhinieri njoftohet përmes sistemit elektronik.
2. Vendimi i Bordit për pezullim ose revokim të licencës përfshihet në regjistrat përkatës të licencave të cilët publikohen në formë elektronike në faqen elektronike të Odës.
3. Kundër vendimit për pezullim ose revokim të licencës, inxhinieri ka të drejtë të paraqes ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditë nga dita e njoftimit të vendimit.

Neni 17

Kthimi i kartelës identifikuese dhe vulës

1. Inxhinieri të cilit i pezullohet ose revokohet licenca, është i detyruar të kthej pa vonesë në Odë kartelën identifikuese dhe vulën.
2. Për kthimin e kartelës identifikuese dhe vulës mbahet shënim i veçantë.

KAPITULLI V

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 18

Dispozita kalimtare

1. Licencat e lëshuara nga Ministria sipas procedurës të Udhëzimit Administrativ MMPHI NR.07/2023 për Procedurën për Licencimin e Arkitektëve të Regjistruar dhe Inxhinierëve të Regjistruar dhe Nënshkrimin e Licencave, janë të vlefshme deri në afatin e skadimit të tyre. Për rilicencim, aplikanti i nënshtrohet procedurës së rilicencimit nga Oda sipas kësaj Rregulloreje.

2. Të gjitha të dhënat e pranuar nga Ministria lidhur me licencimin e inxhinierëve sipas Udhëzimit Administrativ nga paragrafi 1, integrohen në sistemin elektronik të Odës, në afat prej gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

3. Oda do të shqyrtoj dhe vendos, në përputhje me këtë Rregullore dhe brenda afatit prej tridhjetë (30) ditë nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, për aplikacionet e inxhinierëve për licencim të pranuar nga Komisioni i Ministrisë për Themelimin e Odës gjatë periudhës së paraparë të licencimit, të cilat nuk kanë qenë pjesë e Regjistrit të Inxhinierëve dhe nuk janë shqyrtuar nga ky Komision, si dhe aplikacionet që janë deleguar në kompetencë të Odës nga ana e Komisionit Ministror.

4. Të gjitha aplikimet e reja për licencim nga inxhinierët, pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, do të trajtohen gjithashtu nga Oda pa vonesë dhe brenda afateve dhe procedurës së përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 19 **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit nga Kuvendi i Odës dhe publikohet në faqen elektronike të Odës.

Arsim Rapuca

Kryetar i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës